



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.04.2016

Ref.: 234/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, (Departamenti për çështje administrative) A.nr.1369/2012, datë: 10 mars 2016, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 41-të, të mbajtur më 14 prill 2016, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr.074/11, datë: 30.12.2011 e BPrAL Kolegji "Universum" për akreditim të programeve të studimit:
- Menaxhment i Sistemeve të Informatave - SI, BA (180 ECTS)
 - Juridik dhe Menaxhment, BA (180 ECTS)
 - Ndërmarrësi dhe Menaxhment i Bizneseve të Vogla (MA) (120 ECTS)
 - Komunikim në Gjuhë Angleze, BA (180 ECTS)

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Universum" ka parashtruar kërkesë pran Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit: Menaxhment i Sistemeve të Informatave - SI, BA (180 ECTS); Juridik dhe Menaxhment, BA (180 ECTS); Ndërmarrësi dhe Menaxhment i Bizneseve të Vogla (MA) (120 ECTS); Komunikim në Gjuhë Angleze, BA (180 ECTS).

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 14 prill 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Universum", dhe te gjeturat nga vizita e ekspertëve të realizuar më 09.05.2012, dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, dhe më këtë rast mori vendim për mos akreditim të programeve të cekura më sipër.

BPrAL Kolegji "Universum" ka parashtruar kërkesë më nr.074/11, datë: 30.12.2011 për akreditim të programeve të studimit, dhe me këtë rast Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka realizuar vizitën në këtë institucion me 09.05.2012, me ekipin e ekspertëve në përbërje prej: Prof. Dr. Heinz-Ulrich Schmidt, Prof. Dr. Andrew Goodspeed, Prof. Jürgen Bruns, Prof. Dr. Peter Mertens, dhe nga te gjeturat gjatë vizitës, dhe rekomandimeve përfundimtare të dhëna nga ekspertët në raportin final të dorëzuar në AKA me 20.06.2012, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, (Departamenti për çështje administrative) A.nr.1369/2012, datë: 10 mars 2016, dhe dispozitat e shënuara më lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pas vizitës së realizuar nga grupi i ekspertëve (me 09.05.2012) të cilët e kanë vlerësuar programet me të cilat ka aplikuar BPrAL Kolegji "Universum", ekipi i ekspertëve ka hartuar raportin final mbi bazën e të gjeturave gjatë vizitës në këtë institucion dhe dokumenteve shtesë të dërguara nga institucioni në fjalë (me 12.05.2012), dhe mbi këtë bazë ka dhënë rekomandimin final për mos akreditim të programeve të studimit me të cilat ka aplikuar BPrAL Kolegji "Universum".

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Gjykatës Themelore në Prishtinë -
Departamenti për çështje administrative
- BPrAL Kolegji "Universum";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

